



RAPORTI MUJOR I ZYRES SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI (ZRRE)

QERSHOR 2009

Bordi i ZRRE-së

Gjatë muajt qershor, Bordi i ZRRE-së ka mbajtur një seancë në të cilën ka shqyrtuar dhe ka marrë vendim për këto çështje:

- Ka shqyrtuar si dhe ka marrë vendim për 6 ankesa të konsumatorëve.
- Ka marrë vendim për transferim të licencës për Gjenerim të energjisë elektrike, nga ndërmarrja "TGC – INC" tek "KelKos Energy Sh.p.k".
- Ka aprovuar Kodin e Punës dhe Qasjes në Tokë dhe Ndërtesa të OSSH/KEK sh.a..
- Ka aprovuar Kodin e Etikës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) të KEK Sh.A..
- Ka marrë vendim për pranimin e një anëtari të ri të stafit për pozitën e Zyrtarit Ligjor në Departamentin Ligjor dhe të Licencimit.

Departamenti i Çmimeve dhe Tarifave (DTÇ)

- Me 01/06/2009 një anëtar i DTÇ merr pjesë në trajnimin "Price Regulation and Tariffs" të organizuar në Budapest, Hungari.
- Me 03/06/2009 përfaqësuesit e DTÇ janë takuar me përfaqësuesit e KEK sh.a. për të diskutuar faktorët e alokimit të prezantuar nga KEK-u në "modelin alternativ" që KEK-u ka dorëzuar gjatë SHTE3.
- Me 05/06/2009 Kryesuesja e DTÇ-së, Theranda Beqiri ka marrë pjesë në takimin e MPSA-së sektorial për infrastrukturë, me prezantimin "Zhvillimet në përcaktimin e tarifave të energjisë elektrike që reflektojnë kostot".
- Me 15/06/2009 është mbajtur një takim me përfaqësuesin e ESK, për përgatitjen e të dhënave të kostos së prodhimit të energjisë elektrike nga gjeneratorët vendorë.
- Me 25/06/2009 Kryesuesja e DTÇ ka marrë pjesë në takimin e MPSA-së sektorial për infrastrukturë.
- Me 29/06/2009 – është plotësuar pyetësori i ERRRA-s lidhur me metodologjinë e vlerësimit të Bazës së Rregulluar të Aseteve dhe vlerësimin e asetëve.

Departamentit Ligjor dhe Licencave

- Me 2 qershor është mbajtur një takim informativ me përfaqësues të kompanisë "SUN-SOLAR" nga Belgjika, mbi Energji Solare në Kosovë.
- Me 4 qershor është takuar komisioni për vlerësimin e aplikacionit të "AKIDU" dhe TGC-INC për transferim në të licencës tek kompania "KelKos" Energy Sh.p.k.
- Me 11 qershor përfaqësues të LDD-së kanë mbajtur takim me përfaqësues të MEM-it mbi licencimin apo jo të ndonjë kompanie mbi prodhimin e energjisë nga era.
- Me 11 qershor është mbajtur një takim me palë të interesuara mbi prodhimin e energjisë nga era.
- me 17 qershor është mbajtur një takim me përfaqësues të ZRRE-së mbi vazhdimin e vlerësimit të aplikacionit për transferim të licencës nga dhe TGC-INC "KelKos" Energy Sh.p.k.
- Me 22 dhe me 23 qershor kryesuesi i LDD-së ka marrë pjesë në takimet e grupit punues ndërqeveritar lidhur me finalizimin e draft-Ligjit për Energjinë.



- Me 29 qershor është mbajtur takim përfaqësuesit e kompanisë "WIND POWER" ku janë informuar me dokumente shitesë që duhet të dorëzojnë për marrjen e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese
- Me 30 qershor është mbajtur takim me përfaqësues të kompanisë "KTW" për prodhim të energjisë nga era.

Aktivitetet e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK)

- DMK gjatë muajit qershor, ka regjistruar 21 ankesa të konsumatorëve, ka zgjidhur 23 ankesa, ka lëshuar 21 vendime dhe 2 rekomandime, ka pasur 96 biseda direkt me palë dhe 7 biseda telefonike
- Me datë 04.06.2009, përfaqësuesi i DMK ka marrë pjesë në takimin e mbajtur në MPMS lidhur me Planin Social të Veprimit
- Me datë 12.06.2009, përfaqësuesit e DMK-së kanë marrë pjesë në takimin e mbajtur në ZRRE me konsulentin e EPTISA lidhur me përbalueshmërinë e tarifave, procedurave të ndërrimit
- Me datë 22.06.2009, përfaqësuesit e DMK-së kanë marrë pjesë takimin e mbajtur në ZRRE me konsulentin e projektit të NERA-së (Financuar nga Komisioni Evropian) për të diskutuar në lidhje me rrjedhjen e punës së DMK-së
- Me datë 24.06.2009, përfaqësuesit e DMK kanë marrë pjesë në takimin e mbajtur në ZRRE me konsulentin Dennis Colenut lidhur me aprovimin e Rregullave dhe procedurës së shfrytëzimit të paautorizuar
- Me datë 25.06.2009, përfaqësuesit e DMK kanë marrë pjesë në takimin e mbajtur në ZRRE me konsulentët e NERA-s lidhur me Masat e Kualitetit të shërbimit dhe furnizimit.

Aktivitetet lidhur me Ngrohjen Qendrore dhe Gazin

- Me 2 qershor Eksperti i ZRRE-së për Gaz dhe Ngrohje Qendrore, Astrit Saraqini, ka marrë pjesë në takimin në MEM lidhur me ligjin për gazin natyror
- Me 5 qershor është përgatitur prezantimi lidhur me paqyrimimin organizativ, strukturorë dhe funksional të ZRRE-së në STM Infrastructure
- Me 23 qershor është plotësuar pyetësori i dërguar nga EBRD për sektorin e Gazit
- Prej 23 qershor deri me 25 Astrit Saraqini ka marrë pjesë në Takimin e grupit punuese për gaz ECRB në Vjenë.
- Me 24 qershor është mbajtur një takim me koordinatoren për ZRRE dhe NQ Termokos lidhur me procesin e shqyrtimit të çmimeve dhe bashkërendimin e sezonit 2008/2009 si dhe informimin e detajzuar për çështjet e aprovimit të kërkesave të parashtruara në ZRRE.

Zyra e Administratës

Aktivitetet financiare dhe të prokurimit

- janë kryer pagesa për
 - a. paga në shumë prej..... 24,795.23 euro
 - b. mallra dhe shërbime20,652.30 euro
 - c. shërbime komunale.....705.37 euro
- janë tërhequr dy avanse për udhëtim zyrtar jashtë vendit, ndërsa tri tjera janë mbyllur.
- është kryer regjistrimi i të hyrave në sistemin e free- balancit në shumë prej 2,533.18 euro.
- është përsëritur kërkesa në MEF për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike **mallra dhe shërbime në shpenzime kapitale** për projektin capital "Menaxhimi elektronik i dokumentacionit dhe informatave" në shumë prej 72.000 euro, i cili edhe është kryer.
- Zhvillimi i aktivitetit të prokurimit "Furnizim me derivate për nevoja të ZRRE" dhe anulimi i tij.
- Zhvillimi dhe përfundimi i aktivitetit të prokurimit " Mbushja e klimave"



- Zhvillimi i aktivitetit të prokurimit “Furnizim me derivate për nevoja të ZRRE - ritender”, ky prokurim është në proces të realizimit
- Me 19 qershor është nënshkruar kontrata me kompaninë CACTUS për furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative
- Aktivitete tjera të lidhura me fushën e prokurimit, nxjerrja e urdhërblereve, përgatitja e kontratave, monitorimi i realizimit të tyre.

Aktivitete të tjera

- Prej 8 deri me 12 qershor në Chikago dhe Washington të SHBA-së është zhvilluar pjesa e dytë e aktivitetit të Partneritetit në mes ZRRE-së dhe ICC(Komisioni Komercial i Illinoisit). Në këtë aktivitet nga ZRRE kanë marrë pjesë 5 anëtar të stafit, duke përfshirë edhe 2 anëtar të Bordit.
- Prej 7 deri me 20 qershor një anëtar i Bordit ka ndjekur Trajnimin Ndërkombëtar për Strategjinë dhe Rregullimin e Shërbimeve. Ky trajnim është zhvilluar nga PURC/Banka Botërore në Florida ndërsa pjesëmarrja e përfaqësuesit të ZRRE-së është financuar nga USAID.
- Me 24 qershor stafi i ZRRE-së ka plotësuar e pyetësorin për EBRD.
- Kompania konsultuese MERCADOS (Zbatuese e Projektit të Bankës Botërore në ZRRE) ka mbajtur një Tryezë të punës lidhur me Themelimin e Kornizës rregullative për burimet e ripërtitëshme të energjisë në Kosovë.
- Me tre qershor përfaqësues të ZRRE-së kanë marrë pjesë në një takim të mbajtur në Ministrinë e Energjisë dhe Minierave lidhur me studimin e fizibilitetit për Hidrocentralin e Zhurit.